



Data: 05.02.2019

Ref.: 151/190

Në mbështetje të Nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit ISPE, Nr.1501/18, datë 31.10.2018 për riakreditim të programeve të studimit: Studime Evropiane, MA, 120 ECTS (me specializime: Integritime Ekonomike Evropiane, dhe Politikë të BE-së); Studime të Integruara Evropiane, BA, 180 ECTS; Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS; Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS; Ekonomi, BA, 180 ECTS; dhe për akreditim të programeve: Psikologji, BA, 180 ECTS; Gazetari, BA, 180 ECTS, dhe Infermieri, BSc, 180 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji ISPE ka parashtruar kërkesë (Nr.1501/18, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim të programeve të studimit si në vijim: Studime Evropiane, MA, 120 ECTS (me specializime: Integritime Ekonomike Evropiane, dhe Politikë të BE-së); Studime të Integruara Evropiane, BA, 180 ECTS; Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS; Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS; Ekonomi, BA, 180 ECTS, dhe akreditim për programet e studimit: Psikologji, BA, 180 ECTS; Gazetari, BA, 180 ECTS; dhe Infermieri, BSc, 180 ECTS.

Bazuar në Nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionet e Kolegjit ISPE, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të Nenit 10 të UA për Akreditim, ku përcaktohet se *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së"*, erdhi në

përfundim se programet e studimit Studime Evropiane, MA, 120 ECTS (me specializime: Integritet Ekonomike Evropiane, dhe Politikë e BE-së), Studime të Integruara Evropiane, BA, 180 ECTS, Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS, Ekonomi, BA, 180 ECTS, Psikologji, BA, 180 ECTS, Gazetari, BA, 180 ECTS, dhe Infermieri, BSc, 180 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim.

Pos kësaj, Neni 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), përcakton se: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Bazuar në dispozitën e referuar më sipër KShC ka verifikuar numrin e stafit të deklaruar dhe të përfshirë në aplikacion me gradën PhD dhe fushën e studimit të tyre. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzojë aplikacionet e Kolegjit ISPE, pasi që Kolegji ISPE nuk ka plotësuar dispozitat përkatëse ligjore, si në vijim:

1. Për programin e studimit: *Studime Evropiane, MA, 120 ECTS*, bartës të këtij programi Kolegji ISPE ka prezantuar personelin në vijim: Fatbardha Shpati (PhD në Bujqësi dhe Mjedis, Drejtimi: Shkencat e Hortikulturës) dhe Klementina Ngjeci (PhD në Gjeografi).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.* Programi i studimit Studime Evropiane, MA, ka 120 ECTS, dhe, rrjedhimisht, duhet të ketë të paktën dy mësime me gradën akademike PhD, nga fusha e programit të studimit. Fatbardha Shpati sipas diplomës së doktoratës ka fituar PhD në fushën e Bujqësisë dhe Mjedisit, Drejtimi: Shkencat e Hortikulturës, dhe jo në fushën e studimeve evropiane. Ndërkaq, Klementina Ngjeci nuk është e deklaruar për angazhimin në këtë kolegji, sipas afateve të parapara me UA për Akreditim, pasi që dokumentacioni i saj është dorëzuar jashtë afatit ligjor.

Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor”*, IAL ka qenë e obliguar që të deklarojë stafin akademik me së largu deri më 31 tetor 2018. Ndërsa Kolegji ISPE ka dorëzuar në AKA deklaratat e angazhimit të Klementina Ngjeci me 04 janar 2019, pas skadimit të afatit ligjor.

Bazuar në pikën 3 të Nenit 30 të UA për Akreditim, *“Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.* Edhe sikur të pranohej si staf akademik jashtë afatit ligjor për këtë program të studimit, e njëjta nuk mund të jetë bartëse e programit *Studime Evropiane, MA, 120 ECTS*, pasi që fusha e saj e studimit është e Gjeografisë, dhe nuk ndërlidhet me Studimet Evropiane.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Studime Evropiane, MA, 120 ECTS.

2. Për programin e studimit: *Studime të Integruara Evropiane, BA, 180 ECTS*, Kolegji ISPE ka paraparë stafin në vijim për bartës të programeve: Avni Mazreku (PhD në Juridik); Donila Pipa (PhD në Juridik), Aleksander Muskaj (PhD në Juridik) dhe Shkendi Cili (PhD në Juridik).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: “për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.

Programin e studimit: *Studime të Integruara Evropiane, BA, ka 180 ECTS* kredi, dhe rrjedhimisht, duhet të ketë të paktën 3 PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit dhe pas shqyrtimit të temës së doktoratës, u konstatua që vetëm një nga katër bartësit është i fushës Juridike – Integrimet Evropiane, ndërsa tre bartësit e tjerë janë nga fusha e studimeve në Juridik – Civil që nuk është konform kritereve të akreditimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Studime të Integruara Evropiane, BA, 180 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS*, Kolegji ISPE ka paraparë katër personat në vijim për bartës të këtij programi: Gjon Culaj (PhD në Shkenca Politike), Bajram Ibraj (PhD në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie ndërkombëtare) dhe Krenar Ahmeti (PhD në Psikologji Klinike). Ky program ka 180 ECTS kredi dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program Kolegji ISPE duhet të ketë të paktën tre anëtarë të stafit akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit, u konstatua që Gjon Culaj dhe Bajram Ibraj i përkasin fushës së shkencave politike (e përafërt me studimet e sigurisë), ndërsa Krenar Ahmeti është PhD në Psikologjinë Klinike. Ky i fundit nuk ka profil relevant për programin e studimit: *Studime të Sigurisë*. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS*.

4. Për programin e studimit: *Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS* si bartës të këtij programi Kolegji ISPE ka prezantuar: Iris Menga (PhD në Shkenca Juridike) dhe Fejzi Lila (PhD në Shkenca Politike). Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, “IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor”, IAL janë të obliguara të deklarojnë stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2018. Ndërsa Kolegji ISPE ka dorëzuar në AKA deklaratat e angazhimit të Iris Menga me 04 janar 2019, pas pas kalimit të afatit ligjor.

Bazuar në pikën 3 të Nenit 30 të UA për Akreditim, “Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”, andaj Iris Menga nuk mund të merret në konsideratë fare për këtë program të studimit. Ndërsa stafi tjetër Fejzi Lila, nuk mund të pranohet si staf akademik, pasi që i njëjti ka deklaruar se ka marrëdhënie të rregullt të punës në Kolegjin Juridica, e jo në ISPE. Kjo dëshmohet

edhe me deklarin online (e-akreditim), dhe kontratën e punës të deponuar nga Fejzi Lila në AKA. Andaj bazuar në këtë fakt i njëjti nuk mund të jetë bartës i programit, pasi që marrëdhënia e rregullt e punës së tij është një IAL tjetër.

Ky program ka 120 ECTS kredi dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program Kolegji ISPE duhet të ketë paktën dy anëtarë të stafit akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS.

5. Për programin e studimit: Ekonomi, BA, 180 ECTS Kolegji ISPE ka paraparë këtë staf: Rifat Demalija (PhD në Shkenca Sociale dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare), Shkelqim Sirika (PhD në Gjeografi), Petrit Perhati (PhD në Ekonomiks, Profili: Manaxhement), Rezak Jakupi.

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Programin i studimit *Ekonomi, BA, ka 180 ECTS* kredi, dhe rrjedhimisht, duhet t'i ketë të paktën 3 PhD nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit, u konstatua që vetëm një nga katër bartësit, përkatësisht vetëm Petrit Perhati është PhD në Ekonomiks, pra është i fushës përkatëse të programit të studimit, por edhe ky i deklaruar me 04 janar 2019, pra jashtë afatit ligjor, ndërsa dy të tjerët, Shkelqim Sirika (PhD në Gjeografi), dhe Rifat Demalija (PhD në Shkenca Sociale, profili: Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare) nuk kanë asnjë lidhje relevante me fushën e programit të studimit. Ndërsa Rezak Jakupi, nuk mund të pranohet si staf akademik, pasi që i njëjti ka deklaruar se ka marrëdhënie të rregullt të punës në Kolegjin Dardania, e jo në ISPE. Kjo dëshmohej edhe me deklarin e tij online, dhe në kontratën e punës të deponuar nga Rezak Jakupi në AKA.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, siç është paraparë në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Ekonomi, BA, 180 ECTS*.

6. Për programin e studimit: *Psikologji, BA, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji ISPE ka paraparë katër persona: Oreta Saliaj, Mariela Lazi, Lulzim Hoxha, Sazan Guri.

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Programi i studimit *Psikologji, BA, ka 180 ECTS* kredi, dhe rrjedhimisht, duhet t'i ketë të paktën 3 PhD nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit, u konstatua se Kolegji ISPE nuk ka staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për fushën e programit të studimit siç kërkohet në nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Oreta Saliaj ka PhD në Shkenca Politike dhe Lulzim Hoxha, PhD në

Shkenca Sociale, profili: Shkenca Politike, dhe rrjedhimisht, asnjëri prej tyre nuk është i fushës së psikologjisë. Ndërsa Mariela Lazi, nuk mund të pranohet si staf akademik në këtë program të studimit, pasi që e njëjta ka deklaruar se ka marrëdhënie të rregullt të punës në Kolegjin Dardania, domethënë jo në ISPE. Kjo dëshmohet edhe me deklarimin e saj online, dhe në kontratën e punës të deponuar nga Mariela Lazi në AKA.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, siç është paraparë në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Psikologji, BA, 180 ECTS*.

7. Për programin e studimit *Gazetari, BA, 180 ECTS kredi*, Kolegji ISPE ka paraparë katër persona si bartës të këtij programi: Fitor Ollomani (PhD në Letërsi), Alfred Halilaj (PhD në Etnologji dhe Folklor), Ndrimiro Ciroka (PhD në fushën Ekonomi dhe Agrobiznes).

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Programi i studimit *Gazetari, BA, ka 180 ECTS kredi*, dhe rrjedhimisht, duhet ti ketë të paktën 3 (tre) bartës me PhD nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit, u konstatua që Kolegji ISPE nuk ka staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për fushën e programit të studimit siç kërkohet në nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Fitor Ollomani ka PhD në Letërsi, dhe i njëjti ka deklaruar që ka marrëdhënie të rregullt të punës në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”, ndërsa Kolegji ISPE ka përdorur deklaratën e vitit akademik 2017/2018, dhe jo të vitit akademik 2018/2019. Andaj kjo nuk mund të pranohet si dëshmi valide për staf akademik për këtë program të studimit. Ndërsa, Ndrimiro Ciroka ka PhD në fushën Ekonomi dhe Agrobiznes, fushë kjo e cila përbën dallim substancial me programin e Gazetarisë. Sipas nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor”*, pra IAL ka qenë i detyruar që të deklarojë stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Ndërsa Kolegji ISPE ka dorëzuar në AKA deklaratat e angazhimit për Ndrimiro Ciroka me 04 janar 2019, pra pas kalimit të afatit ligjor.

Andaj, bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Gazetari, BA, 180 ECTS kredi*.

8. Për programin e studimit: *Infermieri, BSc, 180 ECTS kredi*, Kolegji ISPE ka paraparë katër persona si bartës të programit: Blerim Lllunji, Abdullah Gruda, dhe Yllka Krasniqi.

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*. Ndërsa, në pikën 5.3.11 të po këtij neni, theksohet se: *“Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr. Sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, (Infermieri BSc, Mami BSc, Gjuhë e Shenjave BSc) do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i*

arsimit të lartë do të sigurojë AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë, i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar”.

Programi i studimit: *Infermieri, BSc, ka 180 ECTS kredi*, dhe rrjedhimisht, duhet t'i ketë të paktën 3 (tre) anëtarë stafi në marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit të paktën me gradën shkencore MA. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit, u konstatua që Kolegji ISPE nuk ka staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për fushën e programit të studimit siç kërkohet në nenin 26, pika 5.3.4 dhe pika 5.3.11 e UA për Akreditim. Nga tre personat e prezantuar si bartës të këtij programi Yllka Krasniqi nuk mund të pranohet si staf akademik pasi që e njëjta ka tri marrëdhënie të rregullta të punës, përkatësisht në Kolegjin Universum, Kolegjin ISPE, dhe Kolegjin UBT. Bazuar në nenin 26, pika 5.3.14 e UA për Akreditim: *“Një anëtar i stafit akademik që është i punësuar me orar të plotë (40 orë në javë) në një institucion të arsimit të lartë, mund të kryej detyra në institucionet e tjera të akredituara me më së shumti, 10 orë angazhim ligjërata, ushtrime, ose mentorime të kandidatëve, që nënkupton gjysmën e normës së plotë prej 20 orë pune”.*

Bazuar në atë çka u referua me lartë, një staf akademik nuk mund të ketë më shumë se një marrëdhënie të rregullt të punës dhe një gjysmë norme. Andaj mbi këtë bazë, Yllka Krasniqi nuk mund të pranohet si bartëse e programit të studimit në Infermieri për shkak se në të njëjtën kohë ka tri marrëdhënie të punës.

Pos kësaj, stafi tjetër i propozuar si bartës për këtë program studimi, kanë kualifikim master në menaxhim shëndetësor, njëri me studime bazë të stomatologjisë (Blerim Llunji) dhe tjetri me studime bazë në mjekësi të përgjithshme (Abdullah Gruda) që nuk i plotësojnë kërkesat e dispozitës relevante, Neni 26, pika 5.3.4. dhe 26, pika 5.3.11).

Andaj, bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit dhe për realizim të marrëdhënies së rregullt të punës në më shumë se një institucion të arsimit të lartë, bazuar në nenin 26, pika 5.3.4, 5.3.11 dhe 5.3.14 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Infermieri, BSc, 180 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “ISPE”;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë